

# J E T A S H K E N C O R E

## MBLEDHJE KUSHTUAR PËRKUJTIMIT TË MAXIMILIAN LAMBERTZIT

Më 20 shkurt 1964 Instituti i Historisë e Gjuhësisë dhe Fakulteti i Historisë e Filologjisë organizuan një mbledhje për të nderuar kujtimin e Prof. Dr. Maximilian Lambertzit, albanolog i shquar dhe mik i popullit tonë. Në këtë mbledhje Prof. E. Çabej foli me hollësi për veprimtarinë e gjerë shkencore dhe kontributet e shquara që ka dhënë ky dijetar në shumë fusha të albanologjisë. Folë-

si vuri në dukje rezultatet e arritura prej M. Lambertzit në fushën e gjuhësisë shqiptare, në shkencën e lehtësisë e në folklorin shqiptar. Në mbledhje merrnin pjesë punonjës shkencorë të Institutit të Historisë e Gjuhësisë dhe profesorë të Fakultetit të Historisë e Filologjisë.

E. L.

## EKSPEDITAT DIALEKTOLOGJIKE TË VITIT 1963

Në këte vit ka vijuar hulumtimi i përgjithshëm i të folmeve të gjuhës sonë me veçoritë kryesore që paraqesin i fenomeneve dialektore e i shtrirjes së tyre. Dyqindetridhjetë e sa vendbanimeve të eksploruara në vitet e mëparshëm iu shtuan edhe 23 vendbanime të tjera.

Ekspeditat u zhvilluan në anë të ndryshme të Shqipërisë nga punonjësit shkencorë të sektorit të dialektologjisë (J. Gjinari, M. Totoni, M. Çeliku, B. Beci). Në një pjesë të tyre muarën pjesë edhe studentë të degës Gjuhë-Letërsi të fakultetit Histori-Filologji që mbledhën materiale plotësuese qoftë në pikat e kërkuara nga dialektologët, qoftë në pika të tjera të atyre zonave. Në pikat qëndrore është qëndruar përgjithësisht 6-9 ditë, në pikat e tjera 2-4 ditë. Është mbledhur një material i pasur që është skeduar e ka pasuruar fondin e Arkivës së Dialektologjisë.

Zonat e eksploruara kanë qenë mirë të përqëndruara në Shqipërinë e mesme dhe veriore. Në jugë janë mbledhur materiale në qytetin e Gjirrokastërës e në rrethin e Tepelenës, kryesisht në krahinën e Lopësit (e pikërisht në Matohasanaj e Labëri,

materiale plotësuese në Bençë, Dhëmblan, Dukat), në fushë të Korçës (në fshatin Bulgarec), në rrethin e Beratit në krahinën e Shpiragut (në fshatin Mbreshtan) dhe në rrethinat fushore të qytetit (në fshatrat Perhondi e Poshnje).

Ekspeditat në Shqipëri të mesme janë zhvilluar në zona të Tiranës e të Durrësit: në Shijak, Ndroq, Pezë, Prezë e Ishëm (e pikërisht në Shahinaj e Sukth, në Ndroq, Korçukje, Pezë e madhe, Ishëm, Bizë, Prezë, Maminas).

Në Shqipëri të veriut është kërkuar Bregu i Bunës në rreth të Shkodrës (fshati Shirq, me materiale të pjesëshme për fshatrat Mushan, Dajç) e më gjerë pjesa më e madhe e zonës së Mirditës, bajrakët e vjetër të Thkellës, Selitës, Kuzhnenit, Oroshit e Spaçit (fshatrat Prosek, Kodër Rrëshen, Zajs, Blinisht, Grykë-Orosh, Kodër-Spaç, në mënyrë të pjesëshme Pshqesh e Mushterhorë).

Të dhënat e grumbulluara zgjerojnë e plotësojnë njohjen që kemi të të folmeve të gjuhës sonë e të fenomeneve dialektore të saj. Një pjesë e tyre do të përpunohen në formë skicash e monografish mbi të folme të ndryshme këtë vit e më pas.

Njëkohësisht me materialet dialektore, gjatë këtyre ekspeditave është mbledhur edhe toponimia e fshatrave, në të cilat është punuar. Këto

materiale po grumbullohen në kartotekën e toponimisë që është ngritur pranë Sektorit të Gramatikës.

M. D.

### EKSPEDITAT LEKSIKOLOGJIKE TË VITIT 1963

Gjatë vitit 1963, sipas detyrave të planit të punës kërkimore-shkencore për sektorin e leksikologjisë e leksikografisë të Institutit të Historisë e Gjuhësisë, u organizuan dy ekspedita 15 ditore ndër krahina, për të mbledhur leksikun dhe frazeologjinë e gjuhës së folur për pasurimin e kartotekës së leksikut të shqipes.

Për herë të parë ekspedita të tilla kërkimore nga sektori i leksikologjisë e leksikografisë janë organizuar në vitin 1958. Por po të krahasohen ekspeditat e atij viti me ekspeditat leksikologjike të vitit 1963 ka ndryshime të mëdha në numrin e pjesëmarrësve dhe në ngritjen e tyre tekniko-profesionale, në përmirësimin e metodave të punës, në zgjerimin e sferës së kategorive të ndryshme të fjalëve që grumbullohen, në ngritjen e nivelit shkencor dhe teknik të materialeve të mbledhura etj. Mund të thuhet se pjesëmarrja ndër këto ekspedita ka qenë një praktikë e domosdoshme dhe dobiprurëse, sidomos për punonjësit shkencorë, si për njohjen e leksikut e frazeologjisë së gjuhës së popullit, ashtu dhe për rritjen e aftësive profesionale për punë kërkimore-shkencore. Në këtë drejtim kanë përfituar edhe arësimtarët e studentët që kanë marrë pjesë në këto ekspedita. Gjithashtu pjesëmarrja e studentëve dhe e bashkëpunëtorëve të jashtëm ka nxitur tek ata dëshirën për të grumbulluar pasurinë e madhe e të çmueshme leksikore e frazeologjike të gjuhës së popullit. Me këtë mënyrë është zgjeruar rrethi i bashkëpunëtorëve të jashtëm, mbledhës të leksikut dhe frazeologjisë shqipe.

Ekspeditat leksikologjike kanë plotësuar kartotekën me një fond të konsiderueshëm fjalësh e shprehjesh të rralla të popullit.

Ekspedita e parë e vitit 1963 u krye në muajin korrik. Ajo përbëhej nga 6 grupe, që udhëhiqeshin nga 6 punonjës shkencorë të sektorit të leksikologjisë e leksikografisë (M. Kazadej, P. Daka, J. Thomaj, M. Samara, Xh. Lloshi e P. Haxhillazi). Në

të muarën pjesë edhe 18 studentë të fakultetit Histori-Filologji dhe 6 bashkëpunëtorë të jashtëm të sektorit (ndër të cilët po përmendim D. Dillaveri, D. Shkodra, S. Trungu, V. Librazhdi). Të gjashtë grupet eksploruan, nga pikëpamja leksikografike, zonat: Dibër (lokalitetet e Qendrës, Lumës, Ralldardhës, Sllovës dhe Zerqanit, 34 pika), Gramsh (të gjitha lokalitetet, 22 pika), Librazhd (26 pika) dhe Malësia e Elbasanit (18 pika). Pra, gjithësejt gjatë kësaj ekspedite u eksploruan 100 pika. Nga të gjitha grupet u grumbulluan 12.200 fjalë e fraza në skeda.

Ekspedita e dytë e vitit 1963 u bë në muajin tetor. Kjo ekspeditë përbëhej nga 5 grupe, të udhëhequra nga punonjësit shkencorë të sektorit (M. Kazadej, P. Daka, M. Samara, J. Thomaj, P. Haxhillazi). Në përbërjen e grupeve ishin 12 studentë të fakultetit Histori-Filologji. Gjatë kësaj ekspedite u eksploruan zonat: Krujë (lokalitetet e Qendrës, Fushë-Krujës dhe Milotit, 24 pika), Durrës (lokalitetet e Qendrës, Shijakut, Lekajt e Rogozhinës, 29 pika), — 53 pika gjithësejt. Gjatë kësaj ekspedite u grumbullua terminologjia e teknikës dhe e prodhimit në N.I.Sh. Cigare e N. I.Sh. Goma — Durrës, e artizanatit të Peqinit-qytet dhe në fabrikën e vaj-sapunit dhe në atë të çveshjes së pambukut — Rogozhinë. Nga të gjitha grupet u grumbulluan rreth 7000 fjalë e fraza në skeda.

Me ekspeditën në Gramsh përfundoi eksplorimi i Shqipërisë jugore dhe u kalua në Shqipërinë e mesme; kurse me ekspeditën e dytë u mbyll edhe eksplorimi i Shqipërisë së mesme (me përjashtim të rrethit të Tiranës) dhe u kalua në Shqipërinë verri-lindore.

Nga të dyja ekspeditat e vitit 1963 u eksploruan 153 pika e 5 qendra prodhimi dhe u grumbulluan rreth 19.200 fjalë e shprehje në skeda. I gjithë ky material u skedua nga mbledhësit në teren. Kjo metodë pune ka sjellë që materialet leksikore

të jenë më të plota e të sigurt, me që në kohën e skedimit mbledhësi ka mundësitë konkrete që t'i plotësojë e t'i verifikojë rastet e dyshimita a të paplota.

Është për t'u theksuar veçanërisht pjesëmarrja më e gjërë në ekspeditat e vitit 1963, sidomos në ekspeditën e parë. Ky fakt ka kushtëzuar edhe numrin e madh të fjalëve dhe frazave të mbledhura. Por materiali leksikor i grumbulluar nga ekspeditat e vitit 1963 pati një përmirësim të ndieshëm nga ana cilësore. Në këto materiale pasqyrohet edhe më gjërë leksiku i botës shpirtërore, leksiku abstrakt, si dhe kategoritë e ndryshme leksiko-gramatikore.

Një ndihmë të madhe u kanë dhënë ekspeditave në teren organet lokale të partisë e pushtetit, në mënyrë të veçantë seksionet e arësimit të rretheve. Në bashkëpunim me ta udhëheqësit e grupeve kanë përcaktuar pikat për eksplorim dhe itenerarin, kanë marrë të dhënat e nevojshme për fshatrat dhe subjektet etj. Një faktor tjetër që ka kushtëzuar

ar rezultatet pozitive të ekspeditave të vitit 1963 ka qenë edhe përgatitja e mire e më konë e tyre. Snumëca e pjesëmarrësve kishin qenë edhe herë te tjera në ekspedita dhe e kishin përvehtësuar mirë metodën e punës (si studentët V. Koreshi, G. Zeneli, M. Zamputi, M. Ristani, P. Skëndo, L. Dino etj.). Para nisjes u dhanë udhëzime të plota, sipas udhëzuesit të ri metodik për mbledhjen e leksikut dhe frazeologjisë shqipe. Një ndihmë në këtë drejtim ka qenë edhe organizimi i seminarëve vjetore, ku bashkëpunorët e jashtëm dhe studentët kanë dëgjuar vërejtjet konkrete për materialet e grumbulluara prej tyre.

Mbledhja e sektorit të leksikologjisë e leksikografisë më dt. 7.1.1964, e cila mori në analizë realizimin e planit të punës kërkimore-shkencore gjatë vitit 1963, e vlerësoi shumë kontributin e ekspeditave leksikologjike për pasurimin e kartotekës së leksikut të shqipes.

J. Th.

## KRIJIMI I KOMITETIT SHQIPTAR PËR STUDIMET BALLKANIKE

Në janar të këtij viti u formua «Komiteti Shqiptar për Studimet Ballkanike» me qendër në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Në komitet marrin pjesë specialistë nga fusha të ndryshme të shkencave albanologjike e ballkanologjike: **Androkli Kostallari** (Kryetar), Drejtor i Institutit të Historisë e Gjuhësisë pranë Universitetit Shtetëror dhe përgjegjës i Sektorit të Leksikologjisë e Leksikografisë së këtij Instituti; Prof. **Aleks Buda** (Nënkrjetar), përgjegjës i Sektorit të Historisë mesjetare të Institutit të Historisë e Gjuhësisë; **Stefanaq Pollo** (Sekretar shkencor), përgjegjës i Sektorit të Historisë së re dhe të sotme të Institutit të Historisë e Gjuhësisë; **Deko Rusi**, Dekan i Fakultetit Ekonomik të Universitetit Shtetëror dhe përgjegjës i Katedrës së Ekonomisë Politike; Prof. **Dhimitër Shuteriqi**, historian i letërsisë, Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë; Prof. **Egrem Çabej**, linguist; **Gani Strazimiri**, përgjegjës i Grupit të Kulturës Materiale të Muzeut Arkeologjik-Etnografik; **Hasan Ceka**, arkeolog; **Ligor Mile**, historian, Zëv.

Drejtor i Institutit të Historisë e Gjuhësisë; **Luan Omari**, Dekan i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit Shtetëror dhe përgjegjës i Katedrës së Teorisë së Shtetit dhe të së Drejtës; Prof. **Mahir Domi**, përgjegjës i Sektorit të Gramatikës e Dialektologjisë të Institutit të Historisë e Gjuhësisë; **Rrok Zojzi**, përgjegjës i Sektorit të Etnografisë të Institutit të Historisë e Gjuhësisë; Prof. **Selman Riza**, linguist; **Selim Islami**, përgjegjës i Sektorit të Arkeologjisë të Institutit të Historisë e Gjuhësisë; **Vehbi Bala**, historian i letërsisë, pedagog në Institutin Pedagogjik të Shkodrës; **Zihni Sako**, Drejtor i Institutit të Folklorit; **Zija Xholi**, pedagog në Katedrën e Filozofisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës.

«Komiteti Shqiptar për Studimet Ballkanike» ka aderuar në «Shoqatën Ndërkombëtare të Studimeve të Evropës Jugë Lindore» me qendër në Bukuresht.

S. P.

## KOLOKIUMI NDERKOMBËTAR MBI QYTETËRIMET BALLKANIKE

Prej 9-14 korrik 1962, në Sinaja (R.P. e Rumanisë), u zhvillua Kolokiumi ndërkombëtar mbi qytetërimet ballkanike, në të cilin morën pjesë shkencëtarë nga të gjitha vendet ballkanike si dhe nga disa vende të tjera. Nisjativën për organizimin e këtij Kolokiumi e mori Akademia e Shkencave e R. P. të Rumanisë si dhe Komiteti Kombëtar rumun për Uneskon.

Detyrë e Kolokiumit ishte, të krijonte mundësinë për të shtruar një varg problemesh shkencore në lidhje me njësinë dhe ndryshmërinë e zhvillimit të popujve ballkanikë dhe për të vënë në dukje lidhjet e shumta ekonomike, politike e kulturele që kanë bashkuar në të kaluarën këta popuj. Pikërisht Gadishulli Ballkanik shtron një varg problemesh shkencore interesante, sepse këtu u zhvillua qysh në një kohë të lashtë një qytetërim i rëndësishëm që lojti një rol të madh në historinë e kulturës njerëzore; këtu u kryqëzuan dhe u mpleksën në mënyrë të frytëshme ndikime dhe marrëdhënie kulturele midis lindjes dhe perëndimit. Prandaj Kolokiumi i Sinajës qe një nisjativë e dobishme që shënoi fillimin e një dialogu shkencor midis përfaqësuesve të shkencës të vendeve ballkanike mbi këtë problematikë të gjerë.

Në Kolokium morën pjesë specialistë nga fusha të ndryshme të historisë, arkeologjisë, gjuhësisë, historisë së letërsisë, të historisë të artit etj. Kishin ardhur nga **Shqipëria**: A. Kostallari, Drejtor i Institutit të Historisë e Gjuhësisë, linguist, M. Domi, linguist, A. Buda, historian (Universiteti i Tiranës); nga **Anglia**: R. Syme (Saim), profesor i historisë romake në Oksford; nga **Austria**: E. Buschbeck, historiani arti, Drejtor i Muzeut të Arteve Figurative Vjenë; nga **Bashkimi Sovjetik**, A. S. Tveritinova, Doktor i shkencave historike (Institutit i popujve të Azisë dhe Afrikës); nga **Bullgaria**: akademiku V. Georgiev, linguist, N/president i Akademisë së Shkencave të R.P. të Bullgarisë, D. Angellov, bizantinist, profesor i Universitetit të Sofies, N. Todorov, historian (Institutit i Historisë së Akademisë së Shkencave); nga **Çekosllovakia**: I. Hrbek, arabist (Institutit i Orientalistikës në Pragë); nga **Franca**: A. Mirambel, Drejtor i Shkollës së gjuhëve të

Lindjes dhe Drejtor i Institutit Neohelenik të Sorbonës; nga **Greqia**: D. Zakythinos, bizantinist, profesor i Universitetit të Athinës, A. Dhaskallaqis, historian po nga ay Universitet dhe P. Jorgunzos, president i Këshillit të lartë pedagogjik të Greqisë; nga **Irani**: Musa Amid, dekan i fakultetit të drejtësisë dhe A. U. Sharifi, profesor i fakultetit të drejtësisë të Universitetit të Teheranit; nga **Italia**: A. Tamborra, historian, profesor i Universitetit të Romës; nga **Jugosllavia**: S. Radoçiç, historiani arti dhe F. Barišić, bizantinist, të dy profesorë të Universitetit të Belgradit; nga **Libani**: K. Abusuan, sekretar i përgjithshëm i Komitetit libanez për Uneskon; nga **Polonia**: akademiku V. Antonieviç, arkeolog; nga **Rumania**: akademiku T. Vianu, profesor i letërsisë krahasuese, akademiku A. Ocetea, drejtor i Institutit të historisë të Akademisë së Shkencave; akademiku G. Opresku, drejtor i Institutit të historisë së arteve, akademiku E. Konduraqi, drejtor i Institutit të Arkeologjisë, akademiku A. Roseti, linguist, E. Petroviçi, profesor i filologjisë sllave, D. M. Pipidi, profesor i historisë antike, M. Berza, profesor i historisë mesjetare, I. Nestor, profesor i arkeologjisë, E. Stanesku, historian, M. Guboglu, orientalist, V. Lipati, historian i letërsisë franceze; nga **Turqia**: profesori E. R. Unat, historian, N/president i Shoqatës së Historisë Turke, H. Z. Koshaj, drejtor i Muzeut Arkeologjik në Ankara; H. B. Jonetken, muzikolog, profesor në konservatorin e Stambollit, N. Berk, profesor në Akademinë e arteve dhe drejtor i Muzeut të arteve në Stamboll; nga **Ungaria**: J. Pereny, historian, profesor i Universitetit të Budapestit. Në punimet e Kolokiumit mori pjesë dhe N. Bamatte, drejtues i seksionit për filozofi dhe shkenca humanitare pranë Uneskos.

Pas fjalimeve të hapjes, të mbajtura nga Presidenti i Akademisë të R.P. të Rumanisë A. Zhozha, nga akademiku T. Vianu dhe N. Bamatte, filluan referatet, që zgjatën 5 ditë rresht. Megjithë larminë e tyre, referatet grupoheshin në dy cikle tematike: uniteti dhe diversiteti i qytetërimeve ballkanike dhe kontributi i botës ballkanike në marrëdhëniet midis lindjes dhe perëndimit. Për t'i

ndjekur më lehtë, ne po i ndajmë këtu referatet në disa grupe.

Periudhës më të lashtë dhe kohës antike u përkasin referatet e akademikut V. Georgiev mbi temën: «Problemi lingistik i përbashkët për popujt ballkanas», të H. Z. Koshait mbi temën: «Njësi dhe ndryshmësi në parahistorinë e Anadollit dhe të Gadishullit Ballkanik», të akademikut V. Antonieviç «Kultura keramike e pikturuar e neolitit në Poloni», të arkeologu rumun G. Dajkoviç, «Kultura e dakëve dhe vendi i saj në qytetërimin ballkanik», të akademikut E. Konduraçi «Ndikime greke dhe romake në Gadishullin Ballkanik», të prof. R. Syme «Rrugët e mëdha ballkanike në kohën e perandorisë romake».

Tematikë mesjetare trajtonin referatet e D. Zakythinos «Sinteza bizantine në antitezën lindie-perëndim», të D. Angellovit «Bogomilizmi në vendet ballkanike dhe ndikimi i tij në Evropën perëndimore» dhe të F. Barishçiçit «Mbishkrime greke mbi monumente arkitektonike të zbuluara në Maqedoni dhe Serbi».

Një grup tjetër referatesh përfshinte probleme që nuk i përkasin vetëm një vendi; këto referate studjonin në mënyrë krahasuese një problem të historisë së popujve të ndryshëm ballkanikë, ose edhe marrëdhëniet e tyre historike-kulturale. Në këtë grup bënin pjesë referatet e N. Todorovit me temën «Përbërja etnike e qytetit ballkanik të mesjetës së vonë», të I. Perenyt «Disa anë të qytetërimit ballkanik në periudhën e shekujve XV-XVIII-të», të A. Dhaskallaqit «Tipare të përbashkëta të lëvizjes çlirimtare të popujve ballkanas», të A. Budës «Njësi dhe ndryshmësi në historinë e popullit shqiptar dhe në historinë e popujve të tjerë ballkanas», të M. Domit «Disa momente e aspekte të kontakteve kulturore të Shqipërisë e të popullit shqiptar», të A. Tamborrës «Ballkanët dhe Italia që nga periudha e rilindjes gjer në shekullin XIX-të». Lidhjeve midis botës arabe dhe Ballkanit u qenë kushtuar referatet e K. Abusuan dhe I. Hrbeç, të cilët folën mbi shtypshkronjat arabe në Ballkan dhe mbi sllavët në shërbim të arabëve në Lindjen e Afërme.

Mbi probleme të lidhura me botimin e burimeve arkivale historike foli A. S. Tveritinova në referatin e saj «Mbi realizimet e orientalistikës

sovjetike në lidhje me botimin e burimeve historike orientale» dhe F. R. Unat «Mbi rëndësinë e arkivave turke për historinë e popujve ballkanas».

Një grup të veçantë përbënin referatet që u ishin kushtuar problemeve të historisë së artit, të literaturës dhe muzikës. Akademiku G. Opresku foli mbi temën «Arti rumun midis arteve të Ballkanit», S. Radoçiç mbi «Lidhje artistike rumunoserbe në dritën e zbulimeve të reja», H. Jonetken mbi «Dhimitri Kantemir në historinë e muzikës turke», N. Berk mbi «Rryma ndërkombëtare dhe folklori vendas në pikturën ballkanike, veçanërisht në pikturën bashkëkohëse turke», A. Mirambel mbi «Kontributin e letërsisë së shoqe greke në marrëdhëniet midis lindjes dhe perëndimit».

Mbi referatet u zhvilluan diskutime të gjalla dhe frytëdhënëse që vunë në dukje në një varg rastesh pajtimin e pikëpamjeve të diskutantëve të ndryshëm po edhe ekzistencën e ndryshimeve parimore të thella në pikëpamjet e tyre. Në diskutimet muarën pjesë krahas kolegëve të tyre dhe përfaqësuesit shqiptarë A. Kostallari, M. Domi dhe A. Buda. Gjatë këtyre diskutimeve u vu në dukje se ekzistojnë një varg problemesh shkencore të përbashkëta për të gjithë popujt ballkanikë në fushën e historisë sociale, ekonomike, politike dhe kulturore. U theksua gjithashtu se, pavarësisht nga këto elemente të përbashkëta, secili nga këta popuj ka tiparet e veta specifike në zhvillimin historik, ka kulturën e vet të veçantë, ka fytyrën e vet. Studiimi i historisë së Ballkanit dhe i marrëdhënieve midis popujve të veçantë ballkanikë përbën prandaj një problem shkencor shumë kompleks, i cili mund të ndërmerret vetëm me pjesëmarrjen e specialistëve të fushave të ndryshme dhe të vendeve të ndryshëm (historianë, arkeologë, etnografë, lingvistë, historianë të artit e të literaturës, folkloristë). Të gjitha këto e bëjnë të nevojshme, siç u theksua që kërkimet e veçanta që ndërmerren sot nga shkencëtarë të vendeve të ndryshme të koordinohen në kuadrin e një shoqate shkencore ndërkombëtare. Në lidhje me këtë, pjesëmarrësit e Kolokiumit vendosën që nga gjiri i tyre të krijohej një komision i përbërë nga dy përfaqësues

për çdo vend ballkanik si dhe nga përfaqësues të vendeve të tjera ku zhvillohen studime ballkanike; ky komision duhej të fillonte punën për krijimin e një shoqate ndërkombëtare të studimeve ballkanike.

Për këtë qëllim u bë një mbledhje e veçantë e këtij komisioni nisjator. Komisioni ngarkoi si kryetar të tij provizor akademikun T. Vianu për të bërë hapat e nevojshme që shoqata e ardhëshme të pranohej në sesionin e XII-të të zakonshëm të Uneskos në Paris në nëndor 1962. Nga

ana e Shqipërisë në komision muan rën pjesë A. Kostallari dhe A. Buda.

Konferenca e zhvilluar në Sinaja që një fillim i mirë për një bashkëpunim të frytshëm midis shkencëtarëve të vendeve ballkanike dhe në përgjithësi të specialistëve në fushën e balkanologjisë. Ajo që një hap i parë për realizimin e bashkëpunimit shkencor në këtë fushë të rëndësishme. Kolokiumi u zhvillua në një nivel të lartë shkencor, në një atmosferë pune të frytëshme.

### THEMELIMI I SHOQATËS NDERKOMBËTARE TË STUDIMEVE TË EVROPËS JUGËLINDORE (A. I. E. S. E. E.)

Prej datës 22 deri 24 prill 1963 u mbledh në Bukuresht komisioni provizor i zgjedhur gjatë Kolokiumit të Sinajas në korrik të vitit 1962 për të ndërmarrë hapat e mëtejshme në lidhje me krijimin e një shoqate ndërkombëtare të studimeve ballkanike. Si përfaqësues të shkencëtarëve shqiptarë në mbledhje merrnin pjesë A. Kostallari dhe A. Buda.

Në rendin e ditës së mbledhjes ishin: hartimi dhe adoptimi i statuteve të shoqatës, zgjedhja e organeve drejtuese, hartimi i programit të veprimtarisë së saj të mëtejshme.

Në lidhje me statutin e shoqatës, pas diskutimesh mjaft të gjata, u vendos që shoqata të mbante emrin «Shoqatë Ndërkombëtare e Studimeve të Evropës juglindore (A.I.E.S.E.E.).» Qendra e saj do të jetë në Bukuresht. Siç e thotë neni 3 i statutit, qëllimi i shoqatës do të jetë «të nxitë studimet ballkanike dhe përgjithësisht të Evropës juglindore, në fushat e shkencave humanitare, d.m.th. të historisë, arkeologjisë, etnografisë, gjuhësisë, filologjisë, letërsisë, folklorit, artit etj. qysh nga kohët më të lashta gjer në ditët tona». Për të arritur qëllimin e vet, shoqata do të japë çdo ndihmë për të intensifikuar shkëmbimet ndërkombëtare në format më të ndryshme, për të lehtësuar bashkëpunimin shkencor dhe takimet midis specialistëve, për të ndihmuar në shfrytëzimin e burimeve në bashkëpunimin e botimeve dhe dokumentave shkencore. Shoqata do të inkurajojë themelimin dhe veprimin e institucioneve që kanë të bëjnë me

studimin e qytetërimeve ballkanike. Ajo do të marrë nisëtiativën për fillimin e punimeve të mëdha të përbashkëta, për thirrjen e kolokiumeve, e mbledhjeve të tjera specialistësh, për organizimin e kongreseve ndërkombëtare, për shkëmbimin e shkencëtarëve, dhënieve e bursave, për botime shkencore të përbashkëta e të tjera (Neni 6). Sipas Nenit 7, anëtarë të shoqatës mund të bëhen komitetet nacionale që do të formohen në vendet e ndryshme ose institucionet shkencore ekzistuese të këtyre vendeve. Vetëm atje ku nuk ekzistojnë as komitete nacionale, as institucione shkencore që të kenë aderuar në shoqatë, pranohen edhe anëtarët individualë. Organet drejtuese të shoqatës janë Komiteti ndërkombëtar dhe Byroja e Komitetit ndërkombëtar. Komiteti Ndërkombëtar përbëhet nga 2 përfaqësues për çdo komitet të vendeve ballkanike dhe nga 1 anëtar për vendet e tjera. Komiteti zgjedh për 4 vjet byronë e vet që i drejton punët e shoqatës midis dy sesioneve të komitetit. Komiteti mblihdhet të paktën çdo dy vjet një herë, ndërsa Byroja një herë në vit.

Në mbledhjen e Bukureshtit u formua Komiteti Ndërkombëtar i shoqatës, i përbërë nga 19 anëtarë: C. Aous-souan (Liban), Fr. Barishic (Jugosllavi), A. Buda (Shqipëri), E. Buschbeck (Austri), Em. Condurachi (Rumani), A. Dascalakis (Greqi), Vl. Georgiev (Bullgari), M. Z. Koshay (Turqi), A. Kostallari (Shqipëri), A. F. Miller (B.R.S.S.) — provizorisht, A. Mirambel (Francë), N. Minissi (Itali), J. Perényi

Hungari), J. Pudiç (Jugosllavi), R. Syme (Angli), N. Todorov (Bullgari), F. Reshit Unat (Turqi), Tudor Vianu



ndërmerret gjithashtu botimi i një «guide» të studimeve t'Evropës jugë-lindore, në të cilën do të jepen informata mbi institucionet shkencore kryesore dhe mbi specialistët e ndryshëm që punojnë mbi tema ballkanike, mbi burimet kryesore arkivale e bibliografike për këto studime. Një detyrë tjetër me rëndësi do të jetë hartimi i një bibliografie kurente të studimeve t'Evropës jugë-lindore. Si pikë kryesore e veprimtarisë shkencore të shoqatës do të jetë përgatitja e kongresit të parë ndërkombëtar të studimeve t'Evropës jugë-lindore më 1966 në Sofie. Për këtë qëllim u paraqit edhe një projekt i tematikës që do të

trajtohet në kongres. Ky projekt do të diskutohet e plotësohet nga komitetet e ndryshme nacionale dhe do të diskutohet pastaj përfundimisht e do të aprovohet në mbledhjen më të afërt të komitetit të shoqatës, e cila do të bëhet në prill 1964 në Sofie. Gjatë vitit 1964 do të fillojë nga botimi edhe «Buletini i Shoqatës Ndërkombëtare të Studimeve t'Evropës juglindore», që do të jetë një organ gjashtëmuor.

Mbledhja e Byrosë dhe rast për takime dhe bisedime të frytshme edhe jasht mbledhjeve zyrtare.

A. B.

### KONGRESI VIII. NDËRKOMBËTAR I STUDIMEVE ONOMASTIKE NË AMSTERDAM

Në ditët e fundit të gushtit të kaluar zhvilloi punimet e tij në Amsterdam i VIII-të Kongres Ndërkombëtar i Studimeve Onomastike.

Dijetarë nga shumë shtete të botës merrnin pjesë në këtë Kongres, i cili u kushtua në mënyrë të veçantë kujtimit të gjuhëtarit frëng Albert Dauzat, iniciatori i organizimit të studimeve onomastike mbi baza ndërkombëtare.

Kongresi u çel më 27 gusht. Nga referatet e kumtesat, vetëm tri u mbajtën në seanca plenare. Siç ndodh zakonisht nëpër kongrese kësojore, shumica e punimeve u zhvilluan në sekcione të veçanta, të cilat punonin në mënyrë paralele. Në këtë Kongres sekcionet ishin nëndë: I. Onomastika e përgjithshme (metodologjia, sistematika, raporte), II. Onomastika indoeuropiane, me nënsekcion Keltologjinë, III. Onomastika gjermanike, IV. Onomastika romane, V. Onomastika sllave e baltike, VI. Onomastika jo-indoeuropiane, VII. Onomastika turke, VIII. Onomastika sociale, IX. Standardizimi i emrave gjeografike.

Është e pamundur të numërohen këtu as pjesërisht referatet e kumtesat që u mbajtën në këtë Kongres, dhe problemet që prekën ato nga fushat më të ndryshme të emrave të vendave (toponomastikës) e të njerëzve (antroponimisë); gjithashtu nuk mund të përmenden diskutimet, shpeshherë shumë interesante, që bënë dijetarë të ndryshëm rreth referateve e kumtesave që u mbajtën. Nga këto, vetëm disa po përmendim këtu, si referate

që zgjuan një interesim të veçantë, si për temat që trajtuan, si për metodën që përdorën në trajtim të tyre, si për parimet që shtruan në atë mes: F. Trier (Gjermani) Emrat e lumenjve dhe ndërtimet hidraulike; J. Pokorny (Zvicër) Lugudunum (Lyon) dhe hyjnia irlandeze lug, C.E. Thors (Finlandë) Deti baltik si një faktor veçues e bashkues në formim të emrave topike, E. De Felice (Itali) Sardenja në Mesdhe sipas toponimisë të bregdetit të saj, H. Guiter, Gjurmime rreth etimologjisë toponimike në trevën pirenore-mesdhetare, e ndonjë tjetër.

Gadishulli ballkanik e përgjithësisht Europa juglindore që përfaqësuar në një shkallë të gjerë në këtë Kongres. Kjo vlen si për numrin e dijetarëve të kësaj treve që morën pjesë aty me referate e kumtesa, si për temat e zhvilluara që i përkasin asaj ane. Po përmendim ndër të tjerë A. Caferoglu (Turqi). Tiparet karakteristike të «epitheton ornans» në Perandorinë osmane, J. Jordan (Rumani) Formimet deminitive në toponimi rumune, M. Sala (Rumani), Natyra e determinanteve në toponiminë rumune, V. Georgiev (Bullgari) Makrohidronimia europiane dhe çështja e djepit të Indoeuropianëve, Y. E. Boeglin (Francë) Emrat e lumenjve të Sërbisë e të Malit të zi, M. Pavlović (Jugosllavi) Gjurmët e Keltëve në Illyrikum, tipi i emrave vllah, I. Pudić (Jugosllavi) Toponimia e mikroregjionit Lepenica në Bosnje, H. Oelberg (Austri) Studimi i gjuhës pararomake të Tirolit mbi

dëshminë e onomastikës, D. Vayakos (Greqi) Studimet toponimike e antroponimike në Greqi, D. J. Georçakos (U.S.A.) Emra vendesh në trevën e Mikenës.

Për herë të parë mori pjesë në një Kongres ndërkombëtar të studimeve onomastike dhe Shqipëria, me Prof. A. Kostallarin, Drejtor i Institutit të Historisë e Gjuhësisë, e me të nënshkruarin. Këta dy përfaqësues të studimeve shqiptare të vendit tonë muarën pjesë në punimet e kongresit me nga një kumtesë. Prof. Kostallari foli në pasdreken e 28 gushtit në një nga sallat e Universitetit të Amsterdemit për «Studimet onomastike në fushën e shqipes». I nënshkruari po në atë pasdreke e në atë vend foli mbi temën «Çështja e

burimit të kolonive shqiptare të Italisë në dritën kryesisht të gjuhës e të emrave vetiake». Të dy kumtesat patën një auditor mjaft të madh dhe u dëgjuan me vemendje të veçantë. U zhvilluan rreth tyre dhe diskutime me karakter pozitiv e me një frymë objektive.

Kongresi u mbyll më 31 gusht. Në seancën plenare të fundit, ndër vendimet që u shpallën nga ana e Komitetit Shkencor, u njoftua se në këtë Komitet u zgjodh si anëtare e përherëshme dhe Shqipëria, me përfaqësues të nënshkruarin. Kjo zgjedhje është sigurisht një sukses i studimeve Shqiptare. Shumë nga miqtë e shumë të Shqipërisë i shprehën urimet e tyre delegacionit tonë.

#### KUVENDI I IV NDERKOMBËTAR I LINGUISTËVE NË MILANO

Nga 2 gjer në 6 shtator 1963 u mbajt në Milano (Itali) Kuvendi IV. Ndërkombëtar i Linguistëve, i organizuar nga ana e «Lidhjes së gjuhëtarëve» pranë Institutit të Gjuhësisë të universitetit Shtetëror të atjeshëm. Ky Kuvend kishte një tematikë më vete: ai iu kushtua trajtimit të së ashtuquajturave «protogjuhë» (Ursprachen), të shikuara në strukturën e në zhvillimin e tyre historik. Brenda kësaj tematike të caktuar B.E. Vidosh i Universitetit të Nijmegenit (Holandë) trajtoi temën «Latinishtja vulgare si shembëll i një protogjuhe»; V. Pizani, drejtuesi i Komitetit organizativ të këtij Kuvendi, foli rreth temës «Burimet dhe formimi i njësisë gjuhësore gjermanike në lidhje me gjuhët e tjera indoeuropiane»; B. Merixhi (Milano) mbi temën «Raportet midis gjuhëve baltike e sillave dhe for-

mimi i një tipi baltik e i një tipi sllav»; E. Rish (Cyrih) rreth temës «Problemi i njësisë gjuhësore greke», G. Garbini (Romë) për «Formimin e njësisë gjuhësore semitike», e J. Knobloch (Insbruk) rreth temës «Koncepti historik i protogjuhës dhe mundësitë e kufitë e zbatimit të parimeve strukturalistike më të».

Në këtë Kuvend, ku u rrahën probleme me rëndësi të gjuhësisë historike edhe gjatë diskutimeve që u zhvilluan, mori pjesë si i ftuar dhe një delegacion i Institutit tonë të Historisë e Gjuhësisë, formuar prej Prof. A. Kostallarit dhe Prof. E. Çabejt. Në diskutimin e tij rreth referatit të mbajtur nga E. Rish, E. Çabej vuri në dukje praninë e disa elementeve parashqiptare në dialektet e greqishtes së vjetër, sidomos në dorishten.

E. Ç.

